



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3168/9 prot

Datë 24/01/2024

V E N D I M

Nr. 85/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24/01/2024, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SARDO” SHPK në procedurën e prokurimit “E Hapur” me nr. REF- 85061-10-24-2023 me objekt: *“Rikonstruksion, modernizim i reparteve/ magazinave të HSH”*, me fond limit 37,138,483.26 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 14.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Hekurudha Shqiptare Sh.A.

Ankimues: “SARDO” SHPK me NIPT K13120402W dhe adresë Lagjja “Apollonia”, Rruga “Jakov Mile”, Z. Kadastrale 8534, Nr. Pasurie 3/5-N12, Fier.

Autoriteti Kontraktor: Hekurudha Shqiptare Sh.A, me adresë Rr. “Egnatia”, Lagjja nr.3, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.10.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E Hapur” me nr. REF- 85061-10-24-2023 me objekt: “Rikonstruksion, modernizim i

reparteve / magazinave të HSH”, me fond limit 37,138,483.26 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 14.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Hekurudha Shqiptare Sh.A.

II.2. Në datën 14.11.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 01.12.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. 1. RSM COMPANY” SHPK	31,520,901.00	Skualifikuar
2. INA “ SHPK	34,498,101.00	Skualifikuar
3. PRO GREEN	34,932,314.00	Skualifikuar
4. SARDO	35,300,000.00	Skualifikuar
5. 5.LIS KONSTRUKSION	32,661,865.00	Skualifikuar

II.3.1. Operatori ekonomik “SARDO” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyen se:

“Në pikën 2.3.11 të kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar

Studio e projektimit

Të jetë e pajisur me Licencë Projektimi dhe të ketë të përfshirë si drejtues Teknik në licencë

- Inxhinier Ndërtimi Profili Struktural - 1 (një)

- Inxhinier Topograf - 1 (një)

- Inxhinier Elektrik -1 (një)

- Inxhinier Mekanik -1 (një)

Studio e projektimit duhet të ketë një punësim jo më pak se 10 (dhjetë) punonjësish , të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimum, muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave e vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar.

Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

Operatori nuk ka paraqitur listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar”.

II.4. Në datën 14.12.2023, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim - Anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 101, datë 18.12.2023.

II.5. Në datën 21.12.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3695 dhe protokolluar me nr. 3168/2023 prot., datë 21.12.2023, e operatorit ekonomik “SARDO” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “SARDO” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3168/2 prot., datë 22.12.2023, u publikuan arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “SARDO” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 3168/3 prot., datë 11.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, të dërgojë pranë KPP-së, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “SARDO” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 25/8 prot., datë 15.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 3168/4 prot., datë 17.01.2024, autoriteti kontraktor Hekurudha Shqiptare Sh.A informon, se operatori ekonomik “SARDO” SHPK ankimues, nuk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor.

II.9. Nga shqyrtimi i materialeve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, pranë Komisionit të Prokurimit Publik në formë shkresore dhe as në sistem elektronik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.I. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, vlen të theksojmë, se për sa i përket pretendimit të autoritetit kontraktor të paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ku informon se: *“[...]Meqenëse autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes nuk ka akses në Sistemin e Ankesave elektronike pasi nuk ka llogari të hapur në portalin e-albania, nuk ka pasur mundësi të shqyrtojë ankesën e paraqitur nga shoqëria “Advanced Business Solution-ABS” SHPK dhe të shprehet mbi pretendimet e ngritura nga ky operator duke mos përmbushur edhe parashikimet e nenit 114 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik [...]”* sqarojmë, se operatori ekonomik “SARDO” SHPK ka paraqitur ankim në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave.

Sa më sipër, vlen të theksojmë, se që në datën 27.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka implementuar sistemin e Regjistrimit Elektronik të Ankesave, duke mundësuar tashmë për të gjithë operatorët ekonomikë paraqitjen e ankesës në të njëjtën kohë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në rrugë elektronike. Me dorëzimin e ankesës në sistemin elektronik, në përputhje me afatet në ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ankesa menjëherë konsiderohet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, njëkohësisht në të dyja institucionet. Ankesa dhe e gjithë përmbajtja e saj është e aksesueshme nga autoriteti kontraktor, në Sistemin Elektronik të Ankesave.

Në këtë kuadër, nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, është kryer një cikël trajnimesh falas, në 12 qarqe të Shqipërisë, ku janë ftuar të marrin pjesë të gjitha institucionet të cilat zhvillojnë procedura prokurimi, si dhe operatorë ekonomikë, të cilët janë njohur mbi mënyrën e funksionimit dhe përdorimit të këtij sistemi. Akoma më tej, më datë 21.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, përmes komunikimit elektronik zyrtar, e ka njoftuar autoritetin kontraktor për paraqitjen e ankesës së sipërpërmendur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për kryerjen e disa veprimeve procedurale në sistemin elektronik të ankesave me qëllim zbatimin e procedurave ligjore.

III.2. Nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “SARDO” SHPK nuk ka bashkëlidhur dokumentin bankar që të vërtetojë, se ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me përcaktimet në pikat 2 dhe 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III.2.1. Në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.2.2. Në pikën 2 gërma “a”, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;”

III.2.3. Në datën 21.12.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3695 dhe protokolluar me nr. 3168/2023 prot., datë 21.12.2023, e operatorit ekonomik “SARDO” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “SARDO” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se kësaj të fundit i mungon dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur, protokolluar me nr. 3168/2023 prot., datë 21.12.2023.

III.2.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të

plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3168/2 prot., datë 22.12.2023.

III.2.5. Me shkresën nr. 3168/3 prot., datë 11.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, të dërgojë pranë KPP-së, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “SARDO” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III.2.6. Nëpërmjet shkresës me nr. 25/8 prot., datë 15.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 3168/4 prot., datë 17.01.2024, autoriteti kontraktor “Hekurudha Shqiptare” Sh.A informon, se operatori ekonomik “SARDO” SHPK ankimues, nuk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor.

III.2.7. Referuar pikës 2, të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3, të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre, në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2, të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efijencës në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

III.2.8. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në mungesë të elementeve formale, autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar dispozitata ligjore në fuqi, konkretisht pa kryer paraprakisht procedurën e përcaktuar në pikën 3, të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të

administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni thekson, se autoriteti kontraktor duhet të njoftojë operatorin ekonomik ankimues me çdo mjet të mundshëm, për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementët formale të ankesës dhe në rast se ky i fundit nuk do i korrigjonte mangësitë e konstatuara brenda 2 ditëve nga njoftimi, atëherë autoriteti kontraktor duhet ta konsideronte ankesën si të paparaqitur. Komisioni gjykon, se privimi i operatorit ekonomik ankimues nga mundësia që i jep ligji për të korrigjuar një prej elementeve formale të domosdoshme, e ka privuar gjithashtu këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se privimi në mënyrë të paligjshme nga e drejta e ankimit, cenon rëndë parimin e ligjshmërisë dhe parimin e një procesi të rregullt ligjor rishikimi administrativ.

Për këtë arsye, bazuar në faktin që tashmë kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për shqyrtimin e ankesës, duke e bërë të pamundur rikthimin në kushtet e ligjshmërisë të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, Komisioni gjykon, se kjo procedurë prokurimi duhet anuluar, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.3. Për sa i përket, ankesës online të paraqitur nga operatori ekonomik “SARDO” SHPK pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me numër ankimi elektronik A/2023/3695 dhe nr. 3168 prot., datë 21.12.2023, i cili kundërshton skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi, KPP konstaton, se përveç faktit që për këtë ankim nuk është paraqitur mandat-pagesë, akoma më tej kjo ankesë është paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimit. Konkretisht:

III.3.1. Sipas informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se në datën 26.10.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “*E Hapur*” me nr. REF-85061-10-24-2023 me objekt: “*Rikonstruktion, modernizim i reparteve / magazinave të HSH*”, me fond limit 37,138,483.26 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 14.11.2023 nga autoriteti kontraktor, “Hekurudha Shqiptare” Sh.A.

III.3.2. Sipas informacionit të autoritetit kontraktor në datën 14.11.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.3.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 01.12.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët

ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. 1. RSM COMPANY” ShPK	31,520,901.00	Skualifikuar
2. INA “ SHPK	34,498,101.00	Skualifikuar
3. PRO GREEN	34,932,314.00	Skualifikuar
4. SARDO	35,300,000.00	Skualifikuar
5. 5.LIS KONSTRUKSION	32,661,865.00	Skualifikuar

III.3.4. Operatori ekonomik “SARDO” SHPK rezulton i skualifikuar për arsyen se:

“-Në pikën 2.3.11 të kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar

Studio e projektimit

Të jetë e pajisur me Licencë Projektimi dhe të ketë të përfshirë si drejtues Teknik në licencë

- Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturë - 1 (një)

- Inxhinier Topograf - 1 (një)

- Inxhinier Elektrik -1 (një)

- Inxhinier Mekanik -1 (një)

Studio e projektimit duhet të ketë një punësim jo më pak se 10 (dhjetë) punonjësish , të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimum, muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave e vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar.

Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

Operatori nuk ka paraqitur listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar”.

III.3.5. Në datën 14.12.2023, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim e Anulimit në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 101, datë 18.12.2023.

III.3.6. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në

fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.

Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Neni 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.3.7. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në rastin konkret referuar informacionit të autoritetit dhe Buletinit të Njoftimeve Publike në faqen zyrtare të Agjencisë së prokurimit Publik (www.app.gov.al), rezulton, se publikimi i njoftimit të anulimit është bërë në datën 14.12.2023. KPP vëren, se operatori ekonomik ankimues “SARDO” SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 21.12.2023, me numër ankimi elektronik A/2023/3695 dhe nr. 3168 prot., datë 21.12.2023, duke kundërshtuar skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt - ankimi.

Në nenin 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: *“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik”. Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se*

operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afatit të parashikuar nga neni 110 pika 2 e ligjit 162/2020, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

III.3.8. Referuar parashikimeve të sipërcituara, në rastin konkret, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të anulimit me datë 14.12.2023 dhe përfundon në ditën e 7-të. Ndërkohë në këtë rast kur operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë me numër ankimi elektronik A/2023/3695 dhe nr. 3168 prot., datë 21.12.2023, është jashtë afati ligjor të ankimit, pasi njoftimi i anulimit ishte publikuar më datë 14.12.2023, çfarë do të thotë që afatet e ankimit kanë filluar më datë 14.12.2023 deri ditën e 7-të më datë 20.12.2023. Më datë 21.12.2023, (datë kur është paraqitur ankesa e operatorit ekonomik ankimues) ishte publikuar njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, i cili është momenti procedural nga ku fillon afati i ankimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesën jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”. Referuar parashikimeve të sipërcituara, në rastin konkret llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për ankesat për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, nis ditën e publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës më datë 21.12.2023, është jashtë afatit të ankimit, për sa kohë që ishte publikuar njoftimi i anulimit më datë 14.12.2023, për procedurën objekt-ankimi, dhe afati i fundit për ankimim ka qenë dita e 7-të, e cila përkon me datën 20.12.2023.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 21.12.2023, jashtë afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10

ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi njoftimi i anulimit është publikuar në sistemin e prokurimit elektronik më datë 14.12.2023, moment procedural nga i cili fillojnë edhe afatet ligjore të ankimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke u paraqitur jashtë afateve ligjore, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjithashtu, KPP ju sjell në vëmendje, se bazuar në manualin e APP nr. 1, datë 24.12.2021 operatorët ekonomikë njoftohen mbi publikimin e njoftim fituesit ose anulimit të procedurës në sistem, sapo publikimi i njoftimit të fituesit ose anulimit është kryer në sistemin e prokurimit elektronik, dhe në këtë kuptim ezaurohen të gjitha mënyrat përmes të cilave operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, vihen në dijeni mbi momentin e njoftimit të fituesit dhe rrjedhimisht mbi fillimin e afateve procedurale të ankimit.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëllojë,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesat e paraqitura nga operatori ekonomik “SARDO” SHPK për procedurën e prokurimit “E Hapur” me nr. REF- 85061-10-24-2023 me objekt: “Rikonstruktion, modernizim i reparteve / magazinave të HSH”, me fond limit

37,138,483.26 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 14.11.2023, nga autoriteti kontraktor, “Hekurudha Shqiptare” ShA.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e nenit 111, pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

